

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës Në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga MTEL GLOBAL SHPK Beograd, Republika e Serbisë, me seli në adresën rr. Milentija Popoviqa 9, njësia 3020, Beogradi i Ri 11070, Republika e Serbisë, nëpërmjet të autorizuarit Ognen Trajkovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 22.04.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin MTEL GLOBAL SHPK Beograd, Republika e Serbisë, me seli në adresën rr. Milentija Popoviqa 9, njësia 3020, Beogradi i Ri 11070, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll mbi PULSEC GmbH nga Vjena, me seli të regjistruar në rr. Krugenstrasse 2/7, 1010 Vjenë, Republika e Austrisë, përmes shitblerjes së pjesës, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 10.03.2026, si dhe të plotësuar më datë 23.03.2026, bazuar edhe në të dhënat dhe aktet e dorëzuara në mënyrë shtesë më datë 15.04.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga MTEL GLOBAL SHPK Beograd, Republika e Serbisë, me seli në adresën rr. Milentija Popoviqa 9, njësia 3020, Beogradi i Ri 11070, Republika e Serbisë, e cila përmes shoqërisë së saj të varur MTEL AUSTRIA GmbH nga Vjena, me seli të regjistruar në Am Euro Platz 2 / Stiege 5, 7. OG, 1120 Vjenë, Republika e Austrisë, do të fitojë kontroll të tërthortë mbi PULSEC GmbH nga Vjena, me seli të regjistruar në rr. Krugenstrasse 2/7, 1010 Vjenë, Republika e Austrisë, përmes shitblerjes së pjesës.

Komisioni filloi me ekzaminimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcave të tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

MTEL GLOBAL SHPK Beograd është regjistruar për telekomunikime pa tel. Ajo merret me telekomunikime, shërbime të komunikimit, multimedia, telefoni celulare, televizion OTT dhe u mundëson përdoruesve të shikojnë më shumë se 400 kanale argëtuese, informative, sportive, filmash, për fëmijë dhe kanale të tjera të preferuara nga Ballkani.

MTEL GLOBAL SHPK Beograd është në pronësi të Telekomunikacioni Republika Srpska shoqëri aksionare, Banja Llukë, Bosnje dhe Hercegovinë, e cila është shoqëri e lidhur e Telekom Srbija, shoqëri aksionare Beograd, Serbi.

Person juridik i lidhur me Telekom Srbija në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën „Maksim Gorki“ 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikimeve me tela, përkatësisht për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: rrjeti i komunikimit publik radiofonik, qasja në internet me brez të gjerë (broadband), shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike të disponueshme publikisht në rrjetin e komunikimit të lëvizshëm publik, ritransmetimi i shërbimeve programore televizive, satelit.

Person juridik i lidhur me MTEL SHPKNJP Shkup¹ është Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rrugën „Maksim Gorki“ 11/1-3, Shkup, Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup operon në tregun e ofrimit të shërbimeve të komunikimit elektronik celular (shërbim parapagues/prepaid) dhe nuk u ofron përdoruesve të saj përfundimtar shërbim celular me kontratë (postpaid). MTELMOBILE SHPKNJP Shkup është një operator i rrjetit virtual celular (ORRVC) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming të zërit, SMS-ve dhe internetit.

Gjithashtu, person juridik i lidhur me Telekom Srbija në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPKNJP Shkup, me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikimeve satelitore.

Veprimtaria kryesore e PULSEC GmbH nga Vjena është ofrimi i shërbimeve në fushën e IT/Sigurisë Kibernetike, përkatësisht ofron zgjidhje të avancuara të sigurisë së IT siç janë: Zgjidhje për mbrojtjen e rrjetit, zgjidhje për mbrojtjen e pikës fundore (endpoint), monitorim i sigurisë SOC 24/7 të rrjetit dhe pajisjeve kompjuterike, siguria e të dhënave, zgjidhje të bazuara në cloud me zero besim etj.

Shoqëria e synuar nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e as nuk ka realizuar të hyra në këtë territor.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit

¹ Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me aktvendimin nr. 08-31/2023 të datës 22.03.2023 miratoi përqendrimin me të cilin MTEL SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rrugën Maksim Gorki nr. 11-1/kati 3, 1000 Shkup, do të fitojë kontroll mbi shoqërinë NEOTEL SHPK Shkup, me seli në bulevardin Kuzman Josifovski-Pitu nr. 15, 1000 Shkup.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.
Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ